



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMLORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:200687

Datë: 08.11.2023

Numri i dokumentit: 05119684

C.nr.1379/15

GJYKATA THEMLORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Valentina Sopjani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.TH nga Klina, rruga "M.D" të cilën e përfaqëson Xhevdet Smakiqi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit K.Hnga Prishtina, rruga "Muharrem Fejza", pa numër, me objekt kontesti pasurim i pabazë, vlera e kontestit 9,000.00€, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesorë publik me datë 19.10.2023, në praninë e palëve ndërgjyqës, me datë 08.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.TH nga Klina.
- II. DETYROHET i padituri K.H nga Prishtina, që paditëses B.TH nga Klina, në emër të pasurimit të pa bazë të ja kthej shumën e të hollave prej 4,700.00€, me kamatë ligjore 8%, që nga dita e paraqitjes së padisë (12.06.2015) e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit, nën kërcenim te përmbarrimit me detyrim.
- III. DETYROHET i padituri K.H nga Prishtina, që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 434.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit, nën kërcenim te përmbarrimit me detyrim
- IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtej shumave të aprovuara si në pikën –II- të këtij dispozitivi të Aktgjykimit dhe atë në lartësi 2,400.00€.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar me datë 12.06.2015, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, pa parashtruar padi kundër të paditurit K.H, nga Prishtina lidhur me pasurimin e pabazë, në vlerë prej 9,000.00€.

I autorizuari i paditëse në padi ka theksuar se paditësja me datë 10.09.2010 ka lidhur kontratën me Nr.1057 për Shitblerjen e Automjetit të tipit Peugeot 107 1.4 HDI, viti i prodhimit 2006, me ngjyrë të kaltër matalike dhe me numër të shasisë VF3PN8HTC88704643, me tani të paditurin K.H, dhe kishte fituar pronësinë mbi veturë. Tutje paditësja pas një periudhe kohore të përdorimit të veturës, vendosi ta shes atë, dhe për këtë ia ka dorëzuar të paditurit veturën për shitje. Shtoi se me marrëveshje gojore me të paditurin veturën ia kishte dorëzuar në zotërim faktik ma datën 02.11.2012 ma qellim që të ndërmjetësoj dhe të asistoj në shitjen e veturës, e gjithë kjo që pas shitjes së veturës i padituri të ia dorëzoj shumën e realizuar nga shitja e veturës paditëses. Shtoi se i padituri nuk i është përmbajtur marrëveshjes gojore duke qene se edhe pas një periudhë shumë të gjatë kohore prej 2 vjet e gjysmë, vetura ishte shitur me datë 04.02.2013, shuma e realizuar ende nuk i është paguar paditëse. Shtoi se janë konsumuar të gjitha elementet e parapara të pasurimit të pabazë sipas nenit 194 të LMD-së paragrafi 1, ku theksohet se “Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetri, është i detyruar te kthej atë që ka marrë nga tjetri, ose për ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”. Shtoi se i padituri është pasuruar pa bazë ligjore ka shitur veturën pronësinë e të cilës nuk e ka pasur, gjë e cila vërtetohet përmes kontratës së shitblerjes dhe përmes këtij veprimi ka përvetësuar fitimin material për vete. Theksi se ai këtë pasurim e ka realizuar në dëm të paditëses, e cila në këtë rast është dëmtuar materialisht, andaj ekziston detyrimi nga i padituri që të bëjë kompensimin e fitimit nga realizimi i shitje së veturës. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, dhe të obligohet i padituri K.H që paditëse në emër të pasurimit të pabazë të ja kompensoj shumën prej 9,000.00€, me kamatë në lartësi prej 8 %, duke llogaritur nga data 04.02.2013, kur i padituri e ka shitur automjetin, si dhe të ja paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

I autorizuari i paditëses në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke sqaruar se paditësja ja ka dorëzuar paditësit veturën se saj të tipit Peugeot 107, me qellim që të ndërmjetësoj në shitjen e saj kurse pas shitjes së saj të ia paguaj çmimin e shitblerjes. Theksoi se bazuar ne nenit 194 të LMD-së se i padituri me veprimet e tij është pasuruar pa bazë juridike, kur e ka shitur veturën e nuk ia ka dorëzuar çmimin e shitjes. Ka theksuar se në bazë të provave të administruara, e veçanërisht me kontratën e datës 28.03.2013, ku paditësi pa pëlqimin dhe autorizimin e paditëses e ka shitur automjetin, duke ia përdorur edhe nënshkrimin.

Mbi bazën e të lartcekurave e ka bërë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë, në aspektin objektiv duke kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të pasurimit të pabazë të ja kompensoj paditëses shumë prej 7,100.00€, dhe atë 5,000.00€ të transferuara për shitblerjen e automjetit dhe 2,100.00€ në emër të pagesës së doganimit, të gjitha këto me kamatë prej 8%, duke llogaritur nga data e shitjes së automjetit nga data 28.03.2013 e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës dhe atë për dy seanca gjyqësore dhe hartimin e padisë në vlerën e përgjithshme prej 448.00€.

I padituri në përgjigje në padi ka deklaruar se thëniet në padi nuk janë të vërteta dhe se kërkesëpadija është tërësisht e pabazë. Shtoi se ekziston fakti se në shtator të vitit 2009 i padituri ia ka shitur veturën e markës Pezho 107, me çmim prej 9,000.00€, për këtë është nënshkruar edhe kontrata me shkrim pranë ndërmjetësuesit “Dani”. Shtoi se paditësja e kishte paguar pjesën e çmimit vetëm 5,000,00€, me datë 08.09.2009, dhe në të njëjtën kohë e ka marrë në posedim automobilin e blerë. Tutje shtoi se marrëveshja ka qenë që pjesën tjetër të çmimit prej 4,000.00€, ta paguaj brenda 2-3 muajve, ajo nuk e kishte paguar fare këtë shumë as që kishte premtuar që do ta paguaj. Shtoi se paditësja në pamundësi që ta paguaj këtë shumë dhe me insistimin e të paditurit që të ja paguaj borxhin prej 4,000.00€, në muajin Nëntor 2012 ia dorëzon të paditurit veturën e përdorur për tri vite, i cila ka qenë në gjendje të havarisur. Shtoi se veturën në fjale ka këmbyer me veturë të markës “Reno Senik”, i cili pas tre muajve i është bllokuar dhe e ka shitur për pjesë skrap. Theksoi se i dëmtuar në këtë rast ka qenë i padituri dhe se padia është e pabazë dhe e pakuptimtë, dhe se edhe po të ekzistonte ndonjë lloj borxhi në mes tyre që në shtator të vitit 2009 i njëjti është parashkruar.

I Padituri në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë kundërshtimeve të theksuara në përgjigje në padi dhe se në momentin kur ai e ka marrë veturën nga paditësja vlera e të njëjtit ka qenë 4,600.00€, kur e ka shit e ka bere ndërrimin e veturës e ka telefonuar dhe i ka thënë se ia ka borxh edhe 400.00€, kjo për arsye se e njëjta e ka mbajtur veturën me tepër se dy vite e ka shfrytëzuar dhe nuk e ka kryer pagesën e kontraktuar. Tutje ka theksuar se sa i përket komunikimeve elektronike komunikimin me vëllain e Blertës e pranon, ndërsa sa i përket kontratës së lidhur në vitin 2013 nuk e mohoi, e njëjta është bërë vetëm me letërnjoftim sepse e tille ka qenë procedura dhe Blerta nuk e ka nënshkruar. Ka theksuar se në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës nuk i ka borxh Blertës vlerën e kërkuar. Tutje ka theksuar se mjetet

që i ka pranuar nga paditësja në emër të blerjes së veturës ka qenë shuma prej 5,000.00€, dhe 500.00€, kjo vërtetohet nga raporti i bankës, e që në total janë 5,500.00€. Ndërsa doganimi i veturës është bërë është bërë nga ana e tij, ku kjo vërtetohet në bazë të kontratës së shitblerjes së Kompanisë Dani dhe dudit Doganor. Ka deklaruar se paditësja i ka mbetur borxh shumë prej 3,500.00€, nga shitblerja e parë e veturës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditëse.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim dhe atë: kontratën me numër 1057 e datës 10.09.2009, transaksionin e datës 08.09.2009, kontratën me numër 174 e datës 28.03.2013, librezën e qarkullimit me numër identifikues VF3PN8HTC88704643 si dhe te dhënat e automjetit, librezën e qarkullimit të datës 16.09.2009 si dhe të dhënat mbi automjetin, dokumentin unik doganor të datës 10.09.2009, transferin bankar të datës 10.09.2009, plani i pagesave për paditësen, transferi i datës 08.09.2009 dhe i datës 16.09.2009, komunikimi me viber dhe messenger facebook, gjendjen e llogarisë bankare nga data 01.09.2009 deri me 01.10.2009.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pjesërisht e bazuar dhe si e tillë është aprovuar.

Nga kontrata me numër 1057 e datës 10.09.2009, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.TH në cilësinë e blerëses dhe K.H në cilësinë e shitësit kishin nënshkruar një kontratë të shitblerjes së automjetit e markës Peugeot 107 1.4 HDI, ngjyra e kaltër metalike me çmimin prej 9,000.00€.

Nga librezja e qarkullimit me numër identifikues VF3PN8HTC88704643 si dhe te dhënat e automjetit, si dhe librezja e qarkullimit e datës 16.09.2009 si dhe të dhënat mbi automjetin, gjykata vërtetoi faktin se bëhet fjalë për veturën e markës “Peugeot 107 1.4 HDI”, ngjyra e kaltër metalike, e cila ishte në pronësi të paditëses Blerta Thaqi.

Nga dokumenti unik doganor e datës 10.09.2009, gjykata vërtetoi faktin se vetura në fjalë është importuar nga Zvicra, çmimi i mallit është vlerësuar 7,800.00 CHF, dhe se vlera e detyrimit doganor ka qenë në 2,090.24 €, personi përgjegjës financiar që ka bërë pagesën ka qenë K.H.

Nga transferi i datës 08.09.2009 dhe i datës 16.09.2009, si dhe nga plani i pagesave për paditësen, gjendja e llogarisë bankare nga data 01.09.2009 deri me 01.10.2009, gjykata vërtetoi faktin se paditëses B.TH me datë 05.09.2009 nga ProCredit Bank Sh.A, i është lëshuar kredia përmes transferit në llogarinë rrjedhëse e depozituar në shumën prej 10,000.00€, si dhe transferet e realizuara nga paditësja B.TH për përfituesin K.H në shumën 5,000.00€, në emër të pagesës për blerjen e veturës, si dhe shuma 500.00€, për shpenzime të tjera për veturë.

Nga kontrata me numër 174 e datës 28.03.2013, si kontratë për shitblerjen komisionarë për automjet të përdorur me kompaninë Alba Tours, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.TH në cilësinë e shitëses dhe Valdet Tahiri në cilësinë e blerësit kishin nënshkruar një kontratë të shitblerjes së automjetit e markës Peugeot 107 1.4 HDI, ngjyra e kaltër metalike me çmimin 4,700.00€.

Ndërsa komunikimi me viber dhe Messenger facebook, gjykata vërtetoi faktin se i padituri K.Hk ishte pasur komunikim me paditësen B.TH dhe me vulluan e saj F.TH të cilin komunikim me F.. me platformën Viber. Nga mesazhet vërtetohet fakti se i padituri e ka marrë veturën e paditëses për shitje në personat e tretë.

Gjykata në këtë çështje ka dëgjuar edhe dëshmitaren SH.J, e cila ka deklaruar se është e informuar lidhur me shitjen e veturës në mes të Paditëses B.TH, dhe të paditurit K.H, vetura është shitur në vlerë prej 5,500.00€, ndërsa pazari është bërë për 5,000.00€, paratë janë dhënë kesh, dhe Blerta e ka mbajtur veturën për rreth dy vite. Tutje ka theksuar se kur Blerta e ka shitur veturën për herën e dytë nuk ka qenë prezent, por ka dëgjuar se Kastrioti e ka mashtruar disa kolegë të tyre, dhe për këtë e ka njoftuar Blertën. Ka deklaruar se nuk ka njohuri për çfarë vlere ja ka shitur Kastriotit veturën, vetëm ka dëgjuar nga Blerta se nuk ja ka dhënë të hollat.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit numër 04/L-007 për Marrëdhënie (tutje LMD).

Me dispozitën e nenit 194 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD-së) është paraparë që: “Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”.

Ndërsa me paragrafin 3 i këtij neni është paraparë që “Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese shitblerja e veturës, markës “Peugeot 107 1.4 HDI”, ngjyra e kaltër metalike, me datë 10.09.2009, ku paditësja B.TH ishte në cilësinë e blerëses, ndërsa K.H në cilësinë e shitësit, ku në bazë të kontratës vetura ishte shitur në vlerë prej 9,000.00€.

Nuk ishte kontestuese as shitblerja e veturës, e bërë me datë 28.03.2013, nga i padituri K.H, sipas kontratës për shitblerjen komisionarë për automjetet të përdorur me Kompaninë Alba Tours, e cila ishte bërë në emër të paditëses B.TH në cilësinë e shitëses, dhe V.T në cilësinë e blerësit, të cilët kishin nënshkruar kontratë të shitblerjes së automjetit dhe se vlera e automjetit ishte 4,700.00€.

Kontestuese në mes të palëve në mes të palëve ndërgjyqëse, ishte baza juridike e padisë, konkretisht vlera e kërkuar e shumës së borxhit të cilin paditësja pretendon se i padituri i detyrohet, si dhe parashkrimi i kërkesës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se i padituri në emër të paditëses e kishte shitur veturën e markës Peugeot 107 1.4 HDI, ngjyra e kaltër metalike me çmimin 4,700.00€, në bazë të kontratës për shitblerjen komisionare me kompaninë Alba Tours, pohim të cilin e kishte bërë edhe në seancat gjyqësore, e po ashtu kishte deklaruar se nga kjo shitblerje nuk i kishte dorëzuar – paguar paditëses asnjë shumë të të hollave në emër të shitblerjes së automjetit të saj.

Gjykata konstaton se meqenëse nga i padituri është shitur vetura e Markës Peugeot 107 1.4 HDI, ngjyra e kaltër në shumë prej 4,700.00€, e cila ka qenë në pronësi të paditëses, dhe mjetet i ka mbajtur për vete pa ndonjë bazë juridike, në kuptim të nenit 194 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i padituri është pasuruar pa baze, pasi që mjetet e paditëses në shumën prej 4,700.00€, deri më tani i ka mbajtur pa ndonjë bazë dhe me këtë është varfëruar pasuria e paditëses deri sa është rritur pasuria e të paditurit siç është përcaktuar në nenin 194 të LMD-se. Andaj është detyrim i të paditurit që të kthejë mjetet monetare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, për të ekzistuar pasurimi pabazë duhet të plotësohen katër kushte: a) që të ekzistoj pasurimi i cili mund të shprehet në rritje të aktivitetit dhe zvogëlim të pasivitetit, b) që pasurimi të jetë shkaktuar në kurriz - dëm të personit tjetër që mund të jetë i shprehur me kalimin e një pjese të pasurisë nga një person në personin tjetër, me pagesën e shumës e të hollave, në dorëzimin e ndonjë sendi apo në kryerjen e ndonjë veprimi, c) që të ekzistoj lidhja shkakore në mes të pasurimit dhe varfërimit dhe d) pasurimi duhet të jetë bërë pa bazë juridike apo në fillim gjegjësisht në krijimin e raportit të detyrimeve baza juridike ka ekzistuar mirëpo me kalimin e kohës ajo bazë ka dështuar. Duke marr për bazë këto rrethana - këto kushte të domosdoshme, që të ekzistoj pasurimi pa bazë, rrjedh se elementet të cilat karakterizojnë pasurimin pabazë janë: zmadhimi apo rritja e pasurisë në njërin anë, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër, lidhja shkakore në mes të zmadhimit dhe zvogëlimit të pasurisë dhe mos ekzistimi i bazës juridike.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditëses është e pjesërisht e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurin që paditëses t'ia paguaj shumat e specifikuara në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për kompensimin në emër të pasurimit pabazë. Elementet të cilat e karakterizojnë pasurimin pa bazë janë: të rritja e pasurisë në njërin anë, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër, lidhja kauzale ndërmjet kësaj rritje dhe zvogëlimi të pasurisë, mos ekzistimi i bazës në ndonjë punë juridike, e që në rastin konkret janë plotësuar në tërësi sepse i padituri K.H pas shitjes me ndërmjetësim të veturës së paditëses B.TH, sipas kontratës me numër 174 e datës 28.03.2013, si kontratë për shitblerjen komisionarë për automjet të përdorur, me kompaninë Alba Tours, ku i padituri në emër të paditëses B.TH, në cilësinë e shitëses dhe V.T në cilësinë e blerësit, kishin nënshkruar një kontratë të shitblerjes së automjetit e markës Peugeot 107 1.4 HDI, ngjyra e kaltër metalike me çmimin 4,700.00€, gjykata konstatoi se i padituri nuk ia kishte kthyer çmimin e shitjes së veturës në vlerë prej 4,700.00€, të cilën ishte i detyruar të ia dorëzonte paditëses, edhe pse e njëjta vazhdimisht ia kishte kërkuar paratë të cilat i padituri i detyrohet. Mbi këtë bazë i padituri është pasuruar pa bazë duke pranuar shumën prej 4,700.00€, në emër të shitjes së automjetit, e duke zvogëluar pasurin e paditëses pasi që nuk i ishte paguar çmimi i veturës së saj në emër të shitjes, nga i padituri.

Gjykata vendosi ta refuzoj shumën prej 2,400.00€, për arsye se paditësja me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar se i padituri i detyrohet me shumë se çmimi i veturës së shitur në vlerë 4,700.00€, sipas kontratës së shitblerjes komisionarë për automjet të përdorur, me kompaninë Alba Tours me numër 174 e datës 28.03.2013.

Sa i përket pretendimit të të paditurit se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, për gjykatën një pretendim i tillë është i pa bazuar, kjo pasi që kontrata me kompaninë Alba Tours me numër 174, është lidhur nga i padituri në emër të paditëses (në cilësi të shitësit) me datë 28.03.2013. Ndërsa në bazë të nenit 352 të LMD-së, është përcaktuar afati i përgjithshëm i parashkrimit ku është paraparë se “Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”, andaj mbi këtë bazë padia është paraqitur brenda afatit kohorë.

Ndërsa sa i përket pretendimit të të paditurit se paditësja, është ajo që i ka mbetur borxh shumën prej 4,000.00€, pasi që nuk e ka përmbushur kontratën e shitblerjes së automjetit nr.1057 të datës 10.09.2009 në tërësi, ku kjo ka qenë arsyeja e ndaljes së mjeteve, një pretendim i tillë për gjykatën është i pabazuar, kjo për faktin se paraprakisht para lidhjes së kontratës me datë 08.09.2009 është bërë pagesa në shumë prej 5,000.00€, ndërsa me datë 16.09.2009, është bërë edhe një pagesë tjetër në emër të veturës në vlerë prej 500.00€, ndërsa kontrata e shitblerjes është lidhur me datë 10.09.2009, ku në VËREJTJEN e kontratës, shkruan se “më nënshkrimin e kontratës – faturës palët i kanë kryer obligimet në mes veti dhe nuk kanë të drejtë reklamacioni. Blerësi deklaron me përgjegjësi materiale dhe penale se obligimi ndaj shitësit është kryer në tërësi”, çka do të thotë se kontrata e datës 10.09.2009, është përmbushur në tërësi, dhe kjo mund të kuptohet edhe nga komunikimet e bëra në mes të palëve në rrjete sociale, pasi që asnjëherë nuk ka pasur ndonjë pretendim nga i padituri për përmbushje të ndonjë detyrimi lidhur me atë veturë.

Ndërsa sa i përket dëshmisë së dëshmitares SH.J, të dhënë në shqyrtimi gjyqësor, gjykata nuk ia fali besimin, pasi që rrjedhimisht dëshmia e saj është pa besueshme dhe në thelb e njëanshme, e orientuar në përpyekjet që të jetë sa më favorizuese për të paditësen, e po ashtu është pjesërisht në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestimore.

Gjykata, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera të të paditurit dhe ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar se e njëjta rrjedhë për pagesë nga data 12.06.2015, kjo bazuar në kërkesëpadinë e paditëses dhe në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurin që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 434.00€, dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 104.00€, për taksën gjyqësore për padi 60.00€, dhe për përfaqësim të avokatit në dy seanca shumën prej (135.00x2) 170.00€.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1379/15, me datë 08.11.2023

Gjyqtarja

Valentina Sopjani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.